



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 492/24 Dt. 12.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale, kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale, për lejimin e realizimit të projektit: “Furnizimi me material ndërtimor për ndërtimin/ renovimin e shtëpive të rasteve skamnore dhe në vështirësi ekonomike”, kështu që, për këtë qëllim lejohet hapja e thirrjes publike paraprake mbledhja e aplikacioneve /kërkesave që vijnë nga rastet skamnore dhe grupet e marginalizuara.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Punës dhe Mirëqenie Sociale, nga kategoria e Mallra dhe shërbime, projekt dy vjeçar.
3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenie Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale,
 - Arkivës së Kryetarit.

